Kronikë

Atentat i trefishtë në Memaliaj/ Ekzekutohet me breshëri kallashi babai i Andrea Kalemit, i plagosin xhaxhanë! Vritet klienti e kamarieri! Pistë hetimi hakmarrja (VIDEO)

Atentat i trefishtë në Memaliaj. Babai i Andrea Kalemit ekzekutohet me breshëri kallashi mbrëmjen e së shtunës në një lokal para godinës së bashkisë në Memaliaj. Pistë hetimi hakmarrja, pasi Andrea Kalemit, i dyshuar si i përfshirë në vrasjen e biznesmenit Edmond Papa në dhjetor të 2022. Dy viktimat e tjera ishin kamarieri dhe klienti i lokalit që u ndodhën aty kur u shkrehën plumbat e kallashnikovit.

- Policia: Autorët dogjën makinën në Mallakastër
- Vendi i 'larë në gjak', pamjet nga atentati në Memaliaj
- Si u vra babai i Andrea Kalemit! Autorët me makinë të zezë, njëri zbriti dhe qëlloi me breshëri kallashi
- FOTO/ Kush janë kamarieri e klienti që u vranë në atentatin në Memaliaj!
- Saga e krimeve që pasuan ekzekutimin e Aleksandër Sadikajt e Edmond Papës në 2022
- U ekzekutua babai 74 vjeç! Dy djemtë Kalemi i shpëtuan atentateve

Redaksia
21 Korrik, 00:12 | **Përditesimi: 21 Korrik, 09:27**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

MEMALIAJ- Tre të vrarë dhe një i plagosur në gjendje të rëndë është bilanci i një atentati të ndodhur mbrëmjen e 20 korrikut 2024 që tronditi qytetin e Memaliajt. Ngjarja është shënuar rreth orës 23:20 në një lokal në lagjen nr.3, para godinës së Bashkisë Memaliaj.

Shënjestër e atentatit ka qenë Shyqyri Kalemi, babai i Andrea Kalemit. Të vrarë kanë mbetur kamerieri 36-vjeçar, Gledio Muka dhe klienti 47-vjeçar, Marsel Çela. Burime për Shqiptarja.com bëjnë me dije po ashtu se në gjendje të rëndë është edhe Artur Kalemi, xhaxhai i Andrea Kalemit. Ai ka qenë i ulur në tavolinë bashkë me të vëllanë Shyqyri (Shyqo) Kalemi, kur ndaj tyre është qëlluar me breshëri kallashnikovi.

Autorët, që dyshohet se kanë qenë të paktën 3 persona, kanë ardhur me makinë të zezë nga qyteti i Memaliajt në drejtim të lokalit. Një prej tyre ka zbritur nga mjeti dhe ka qëlluar me breshëri në drejtim të 74-vjeçarit Shyqri Kalemi, i cili ishte ulur në një tavolinë jashtë lokalit. Plumbat kapën dhe vëllanë e tij, si edhe kamarierin që ishte pranë tavolinës. Ndërkohë, klienti që mbeti vdekur ka qenë brenda në lokal.

LEXO EDHE:
Dalin foto, kush janë kamarieri e klienti që u vranë në atentatin në Memaliaj! Shënjestër ishte babai i Andrea Kalemit

Report Tv dhe Shqiptarja.com sollën pamjet nga vendi i ngjarjes, ku dallohet vendi i 'larë në gjak', ndërsa xhamat përtokë nga breshëria e kallashit. Pas atentatit, autorët janë larguar në drejtim të Mallakastrës, ku edhe kanë djegur makinën në fshatin Bejaj.

Policia dhe grupi hetimor kanë sekuestruar pamjet e kamerave të sigurisë në zonë, të cilat do të ndihmojnë për zbardhjen e plotë të dinamikës së ngjarjes, si edhe mund të hedhin dritë në identifikimin e autorëve të këtij krimi të rëndë. 3 persona janë shoqëruar në polici dhe kanë dhënë dëshmi.

Pistë hetimi është hakmarrja, pasi 74-vjeçari është babai i Andrea (Adriatik) Kalemit. Ky i fundit dyshohet të jetë i përfshirë në ***vrasjen e biznesmenit Edmond Papa*** në dhjetor të 2022. I moshuari nuk arriti ti shpëtojë plumbave të kallashnikovit siç ndodhi me dy djemtë e tij që kishin arritur t'i shpëtonin atentateve të mëparshme.

Hakmarrja ndaj Kalemit pistë hetimi

Dyshohet se vrasja ka lidhje me Andrea Kalemin dhe sagën e vrasjeve të nisura në 2022, me eliminimin me eksploziv të Aleksandër Sadikajt, i cili ishte kushëriri i Kalemit, dhe disa muaj më vonë, në Tiranë të biznesmenit Edmond Papa. Një nga pistat e hetimit është hakmarrja ndaj Andrea Kalemit.

RENEA e drejtuesit e lartë të policisë në Memaliaj

Forcat Speciale RENEA, Forcat Kombëtare të Sigurisë kanë shkuar në Memaliaj për të ndihmuar në identifikimin dhe arrestimin e autorëve. Gjithashtu kanë shkuar dhe drejtues të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Kush është Andrea Kalemi

Andrea Kalemi nuk është emër i panjohur për policinë shqiptare ndërsa rezulton bashkëpronar i kompanisë "Shiza Kalemi" sh.p.k në Memaliaj për tregtim me pakicë dhe shumicë të produkteve, restorant, pika servisi, parkime, lavazhe, hotele, e më gjerë.

Në vitin 2001 ai rezulton i arrestuar nga forcat speciale RENEA dhe ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet belge, pasi akuzohej se në bashkëpunim me vëllain e tij Fatmir Kalemi kishte vrarë vëllezërit Mevlan e Adriatik Çaça, ngjarje e ndodhur në Anderleht, më 13 prill 2001. Në 2017-ën u arrestua në Tiranë me 2 të tjerë pasi duke qenë edhe nën efektin e alkoolit, kundërshtuan punonjësin e policisë në detyrë, duke prishur rendin dhe qetësinë publike. Dyshohet se u përfshi në vrasjen e Edmond Papës në dhjetor 2022, ndërsa arriti ti shpëtojë dy atentave.

Në gusht të 2023 Andrea Kalemi ***u tentua të vritej*** në ishullin Pax të Greqisë, por 51 vjeçari mbeti i plagosur, ndërsa në dhjetor të këtij viti u plagos në një burg grek. Ndërkohë në janar 2024, Zamir Kalemi ***i shpëtoi atentatit*** kur persona ende të paidentifikuar qëlluan makinën në të cilën udhëtonte pranë rrethrrotullimit të Selitës në Tiranë. Ai u plagos në këmbë.

Atentati në Memaliaj 20 korrik 2024
Të vrarë 1- Shyqyri Kalemi 74 vjeç (babai i Andrea Kalemit) 2- Gledio Muka, 36 vjeç (kamarier) 3- Marsel Çela 47 vjeç (klient)
I plagosur Artur Kalemi, 57 vjeç (xhaxhai i Andrea Kalemit)

****Raporton për Report Tv dhe Shqiptarja.com gazetari Piro Nase***

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 09:19

Dalin foto, kush janë kamarieri e klienti që u vranë në atentatin në Memaliaj! Shënjestër ishte babai i Andrea Kalemit

Kamarieri, Gledio Muka dhe klienti Marsel Çela

Shqiptarja.com ka siguruar fotot e dy viktimave në atentatin në Memaliaj, ku shënjestër ishte babai i Andrea Kalemit. Shqiptarja.com sjell foton e kamarierit Gledio Muka, 36 vjeç, dhe klientit Marsel Çela, 37 vjeç.

Të dy mbetën të vrarë pas breshërisë së kallashnikovit që u derdh në drejtim të babait të Andrea Kalemit, Shyqyri Kalemi.

Kamarieri mësohet se ka qenë pranë tavolinës së shënjestrës kur është qëlluar, ndërsa klienti Çela ka qenë në lokal, por është kapur nga plumbat.

Ndërkohë, 74-vjeçari Shyqyri Kalemi ka qenë në tavolinë me të vëllanë tij, i cili ka mbetur i plagosur.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 07:41

Detajet/ Si u vra babai i Andrea Kalemit dhe dy të tjerët! Autorët erdhën me makinë të zezë, njëri zbriti dhe qëlloi me breshëri kallashi

Të paktën 3 autorë dyshohet se kanë marrë pjesë në atentatin e trefishtë në Memaliaj, ku mbeti i vrarë babai i Andrea Kalemit, kamerieri dhe një klient. Po ashtu në gjendje të rëndë shëndetësore është edhe xhaxhai i Andrea Kalemit, Artur Kalemi.

Burime bëjnë me dije se autorët kanë qenë me një makinë të zezë. Kanë ardhur nga qendra e Memaliajt dhe kanë shkuar drejt lokalit pranë bashkisë. Njëri ka zbitur nga makina dhe ka qëlluar me breshëri kallashi drejt shënjestrës, Shyqyri Kalemi.

Më pas autorët janë larguar drejt Mallakastrës, ku në fshatin Bejaj kanë djegur edhe mjetin e përdorur në krim.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 07:19

Report Tv sjell pamjet nga atentati i trefishtë në Memaliaj, vendi i 'larë në gjak', xhamat përtokë nga breshëria e kallashit

Report Tv dhe Shqiptarja.com sjellin pamjet nga lokali ku ka ndodhur atentati ndaj babait të Andrea Kalemit. Siç shihet edhe në këto pamje, dallohet tavolina ku ka qenë ulur Shyqyri Kalaemi bashkë me të vëllanë Arturin.

Në vend dallohen njollat e gjakut dhe xhamat e thyer nga breshëria e kallashit. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 23:20 të 20 korrikut në një lokal pranë bashkisë. Grupi hetimor ka sekuestruar pamjet e kamerave të sigurisë në zonë dhe po punon për zbardhjen e plotë e ngjarjes.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 07:09

Atentati i trefishtë në Memaliaj, i plagosur rëndë edhe vëllai i Shyqyri Kalemit! Ishin në tavolinë bashkë

Shqiptarja.com sjell detaje të reja nga atentati i trefishtë në Memaliaj. Burime bëjnë me dije se ka mbetur i plagosur rëndë edhe vëllai i Shyqyri Kalemit. Të dy kanë qenë bashkë në tavolinë kur janë qëlluar me breshëri kallashi. Babai i Andrea Kalemit, Shyqyri Kalemi, ndërroi jetë. Ndërkohë, vëllai i tij Artur Kalemi është në gjendje të rëndë shëndetësore në spital.

Ndërkohë, i vrarë mbeti edhe kamarieri Gledio Muka, 34 vjeç, i cili ka qenë afër tavolinës së shënjestrës. Ndërsa klienti Marsel Çela ka qenë brenda në lokal dhe aknë kapur plumbat e automatikut. Për pasojë edhe ai humbi jetën.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 01:49

Atentati me 3 të vrarë në Memaliaj, saga e krimeve që pasoi ekzekutimin e Aleksandër Sadikajt e Edmond Papës në 2022



Burimet nga grupi hetimor bëjnë me dije se objektiv i atentatit të ndodhur në orët e vona të mbrëmjes së të shtunës, 20 korrik 2024, në qytetin e Memaliajt ka qenë Shyqo Kalemi, babai 74 vjeçar i Andrea Kalemit. Plumbat i morën jetën dhe kamarierit dhe klientit të lokalit ndërsa një tjetër u plagos.

Një nga pistat e hetimit është saga e vrasjeve të nisura në 2022, me ekzekutimin me bombë të Aleksandër Sadikajt dhe disa muaj më pas të Edmond Papës. Shqiptarja.com jua sjell në kujtesë të renditura me data.

11 qershor 2022 - Aleksandër Sadikaj vritet në një shpërthim me telekomandë. 27 vjeçari ishte kushëriri i Kalemëve. Sadikaj po lëvizte me makinë në aksin e njohur si Sauk-TEG. Autorët dyshohet se kishin vënë një sasi të konsiderueshme prej 150 gramësh tritol të komanduar me telekomandë, në pjesën e përparme të makinës e cila është aktivizuar gjatë lëvizjes.

16 dhjetor 2022 - Gjashtë muaj më pas **vritet në Tiranë biznesmeni sarandiot Edmond Papa**. Vrasja ishte hakmarrje për vrasjen e Sadikajt. Për ekzekutimin e tij i arrestuar është shoku i Andrea Kalemit, Albano Velo, ndërsa në kërkim është shoku tjetër Andreë Bode. Në dosjen hetimore përmendet edhe emri i Kalemit.

Më 9 gusht 2023 Andrea Kalemi i shpëton atentatit në ishullin Pax të Greqisë, teksa kishte shkuar me pushime me 3 fëmijët dhe gruan e tij.

Më 14 dhjetor 2023 Andrea Kalemi plagoset me thikë në burgun "Koridhalos" në Greqi. Autori sipas mediave grekte kishte qenë një 28-vjeçar egjiptian.

Më 8 janar 2024 Prokuroria e Tiranës përfundon hetimet dhe dorëzon ***në gjykatë dosjen penale ndaj Andreë Bodes dhe Albano Velos***. Prokuroria thotë se Papa dyshohet se u vra në shenjë hakmarrje për vrasjen e Aleksandër Sadikajt i njohur si 'Sanço'

Më 12 janar 2024 Tentohet të vritet vëllai i Andrea Kalemit i njohur dhe si Adriatik Kalemi. Nga një makinë në lëvizje u qëllua me kallashnikov drejt Smartit me të cilin po udhëtonte Zamir Kalemi. I riu mbeti i plagosur në këmbë.

Më 20 korrik 2024 ekzekutohet në lokal Shyqo Kalemi, 74 vjeç babai i Andrea dhe Zamir Kalemit. Nga plumbat e kallashnikovit mbeti i vrarë dhe Gledio Muka dhe M. Çela. Pas krimit autorët janë larguar me shpejtësi në drejtim të Mallakastrës me një automjet të cilin dyshohet se e kanë djegur në fshatin Bejaj, Mallakastër.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 01:28

Tre të vrarë në Memaliaj, ekzekutohet babai i Andrea Kalemit! Dy djemtë i shpëtuan atentateve në Greqi e Tiranë

Foto: Shyqo Kalemi dhe Andrea Kalemi, babe e bir

Një nga tre viktimat e atentatit të ndodhur mbrëmjen e së shtunës në Memaliaj është Shyqo Kalemi, babai i Andrea Kalemit i njohur dhe si Adriatik Kalemi i cili dyshohet të jetë përfshirë në vrasjen e Edmond Papës në dhjetor të 2022.

Dy djemtë e tij, Andrea Kalemi dhe Zamir Kalemi kanë arritur ti shpëtojnë atentateve gjatë vitit 2023 dhe së fundmi në janar të këtij viti.

Andrea Kalemit i ka shpëtuar një **atentati** më 10 gusht 2023 në ishullin Pax të Greqisë. Ai u qëllua të paktën 10 herë në sy të tre fëmijëve dhe bashkëshortes së tij nga një person i cili kishte fytyrën të mbuluar dhe është larguar pa u vënë re nga askush. Në dhjetor 2023 u qëllua me thikë në burgun e Koridhalos në Greqi.

Në 12 janar 2024 tek rrethrrotullimi i Selitës në Tiranë iu bë atentat Zamir Kalemit. Persona ende të panjohuar qëlluan me kallashnikov drejt makinës së djalit të Shyqos, vëllait të Andrea Kalemit. 40 vjeçari Zamir Kalemi arriti ti shpëtojë atentatit duke u plagosur në këmbë.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 01:24

Atentati me 3 të vrarë në Memaliaj, autorët u larguan drejt Mallakastrës ku dhe dogjën makinën! RENEA në aksion për arrestimin e autorëve

Një grup i posacëm hetimor po punon për zbardhjen e autorëve të vrasjes së rëndë të ndodhur mbrëmjen e së shtunës në Memaliaj. Policia informon se nga veprimet e para hetimore dyshohet se autorët menjëherë pas ngjarjes janë larguar me shpejtësi në drejtim të Mallakastrës me një automjet të cilin dyshohet se e kanë djegur në fshatin Bejaj, Mallakastër.

> *Memaliaj/Informacion paraprak*
>
> *Rreth orës 23:20, në lagjen nr. 3, Memaliaj, në lokalin e shtetasit K. K., në rrethana ende të paqarta janë vrarë me armë zjarri shtetasit Sh. K., 74 vjeç, M. C., 47 vjeç dhe G. M., 36 vjeç si dhe ka mbetur i plagosur shtetasi A. K., 57 vjeç, i cili është transportuar për në spital, për të marrë ndihmë mjekësore.*
>
> *Shërbimet e Policisë, me marrjen e njoftimit, shkuan menjëherë në vendin e ngjarjes dhe kanë ngritur pika kontrolli në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, Berat, Vlorë.*
>
> *Në drejtim të Memaliajt janë nisur Forcat Speciale Renea, Forcat Kombëtare të Sigurisë si dhe drejtues të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.*
>
> *Nderkohë është ngritur një grup i posaçëm hetimor në drejtimin e Prokurorisë dhe me ekspertë të Departamentit të Policisë Kriminale ku vijojnë punën në vendngjarje për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorëve.*
>
> *Nga veprimet e para hetimore dyshohet se autorët menjëherë pas ngjarjes janë larguar me shpejtësi në drejtim të Mallakastrës me një automjet të cilin dyshohet se e kanë djegur në fshatin Bejaj, Mallakastër.*
>
> *Forcat Kombëtare të Sigurisë dhe Renea kanë shkuar në vendin ku po digjet automjeti, kanë rrethuar zonën dhe vijojnë kontrollin për kapjen e autorëve.*

S.G/Shqiptarja.com

Share

S.G/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Gjirokaster | memaliaj | andrea kalemi | mallakaster | Shyqyri Kalemi | Gledio Muka | Marsel Cela | Artur Kalemi | edmond papa | aleksander sadikaj | atentat i trefishte ne memaliaj

Komento

Komente

Qaniu: 21/07/2024 08:36

Shyqua në orën 23-20' në kafe! Me krimet që qunat e Shuqos paskën bo,Shuqua e paska pasur mbas vetes vrasjen,po rreziku i 2 të tjerëve që shkuan kot.

Përgjigju

Faik: 21/07/2024 08:02

Ata që kanë bërë këtë KRIM , janë MONSTRA , KANIBALË , dhe KRIMINELË të NEVERITSHËM !!! VAFSHI në DJALL , dhe u DJEGSHI në HELL , ISHALLA , O ZOT i MADH !!!! NEVERI dhe URREJTJE për të tillë MONSTRA , që për mua Personalisht , janë edhe më KRIMINELË , sesa ÇETNIKËT SERBË !!!! Ju donit ENVER HOXHËN , që t'ju SHKËRDHENTE të KATËRMBËDHJETAT !!! Si mund të vrasësh një MOSHATAR 70 e ca Vjeç .??????????? MONSTRA , KANIBALË dhe KRIMINELË !

Përgjigju

Po mër po: 21/07/2024 08:40

Kanibali ha kanibalin

Arben: 21/07/2024 07:58

Tani do dale Taulant Balla me statistika te reja! Duke llogaritur edhe keto vrasje prape ne kohen e Saliut numri i vrasjeve ishte me i madh! Duhet te ndodhin edhe 100 vrasje kete vit qe te barazohemi statistikisht me numrin vrasjeve ne kohen e Saliut! Prandaj gjerat po shkojne mire!

Përgjigju

Taulant Balla: 21/07/2024 07:54

Si tha i bukuri i gjimnazit, Taulant Balla qe eshte ulur niveli i kriminalitetit ne Shqiperi?! Tao, tek ty eshte rritur nr i viktimave te pafajshem, ne kohen tende po vriten me bresheri o kriminel.

Përgjigju

Deni: 21/07/2024 07:30

Te dashur komentues apo komentatore,kur ju e paske i ditur perpara policise kete muhabet perse nuk e parandaluat krimin makaber? Me thoni nje vend te botes ku parandalohet i tille krim…aro qe kane vrare atje shkofshin…per te ndjeret qe e kane ngrene kot nuk ka faj as policia as politika,vendi yne qenka thjesht i mbusgur me te tille shkerdhata per mos me prish gojen me tej ku per te eliminuar nje zvarranik,nuk marin parasysh se aty mund te jene ulur femije apo dhe familjare te tyre…

Përgjigju

Plepi: 21/07/2024 07:08

Po Taulanti eshte nisur drejt vendngjarjes apo jo?Se vetem ai I jep drejtim gjerave si S.Tahiri njere e nje kohe!!!

Përgjigju

Duhet te kapen me cdo kusht: 21/07/2024 07:02

Kriminele ordinere qe per te vrar ne 74 vjecar vrasin dy te pa fajshem. Nuk afroheshin dot ta ekzekutonin me nje plumb ne kok po vrasin njerz te pa fajshem gjynah i zotit

Përgjigju

EDI RAMA: 21/07/2024 05:29

Dhe ME KETE VIDEO JU UROJ NJE JAVE TE MBARE...

Përgjigju

Graniti: 21/07/2024 04:26

Kam votuar historikisht ps po kësaj radhe ca kam fis miqësi do i coj ku te jete vetëm te ps jo e dogje vendin na rangjet mishin kur hapim TV ska me intutcione ska asgjë tallen me shqiptaret na shpifet jetën vetëm kurveri llum vrasje ka ky vend

Përgjigju

Po mër po: 21/07/2024 08:40

Ti dje u linde, historikisht

Shkëmbi: 21/07/2024 08:29

Granit! Votoje Saliun & Meten se dotë ketë ndryshime në këtë vend!

Gazepi: 21/07/2024 02:09

He mo rama po tani kokat henkshi me njeri tketrin po ckudur kan keta te shkretet po mase te plas ndonjeher te green coast plere me ekta dhker,,,,ta polica

Përgjigju

Beni: 21/07/2024 01:26

Kokat hengshin tha ai i gjati,po na ikin njerez te pafajshem o KM.

Përgjigju

Zini Qori: 21/07/2024 00:43

ÇOHU Enver Hoxha nga varri.

Përgjigju

Rrrrrrrrrr: 21/07/2024 00:39

Ca behet keshtu o rama o te q,,,, policin vdesin njeres kot

Përgjigju

i pergjegjeshmi: 21/07/2024 08:40

po cfaj ka policia o popull i injorant, spiun, lepires, servil. po pse doni te vriteni si kafshe faj prape policia

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH COM

Sondazhi i ditës:
Jeni dakord që në Shqipëri të ndalohet përdorimi i euros për pagesa?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Gjirokastër/ Zjarr në malin e Sopotit, zjarrfikësit në 'luftë' për shuarjen e flakëve
20 Korrik, 13:27

Rama: Qilimi i gurtë i mirëseardhjes në Gjirokastër, drejt përfundimit
20 Korrik, 10:18



Gjirokastër/ Vetëtima shkakton zjarr në urën e Kardhiqit
19 Korrik, 16:34

Gjirokastër/ Zjarri djeg një sipërfaqe me shkurre, rrezikohen banesat
19 Korrik, 15:13



Media amerikane "CN Traveler": Zbuloni Shqipërinë, perlën e fshehur të Evropës
19 Korrik, 08:14

Memaliaj/ Kanosi me sëpatë bashkëshorten, në pranga 61-vjeçari
18 Korrik, 16:24

Memaliaj/ Shpërthen bombola e gazit në banesë, rrezikohet jeta e 65- vjeçares

15 Korrik, 21:09

Qëndrime kritike nga UNESCO mbi Beratin dhe Gjirokastrën për autoritetet shqiptare

15 Korrik, 20:59

VIDEO/ 19 vite në UNESCO, Gjirokastra qyteti muze të merr frymën me shikimin e parë

15 Korrik, 14:49

Në luftë me flakët që prej orëve të para të mëngjesit, shuhet përfundimisht zjarri në Malin e Gjerë

Piro Nase

12 Korrik, 18:45

Situata e zjarreve në vend, Ministria e Mbrojtjes: 3 vatra aktive në Delvinë, Gjirokastër dhe në Liqenet e Lurës

12 Korrik, 10:01

Dy vatra zjarri aktive në vend/ Në Dropull, flakët rrezikojnë fshatin Terihat! Në Delvinë u riaktivizuan sot në mesditë, në ndihmë 2 avionë nga Greqia

11 Korrik, 15:39

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje